



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**



RREGULLORE

MBI BOTIMET MËSIMORE – SHKENCORE NË

UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

(e përditësuar)

**Miratuar me Vendimin nr. 41, datë 29.04.2022,
ndryshuar me Vendimin nr. 101, datë 03.10.2025
të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

Neni 1

Baza ligjore

1. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
2. Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
3. Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
 - 3.1 Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar;¹
 - 3.2 Rregullorja “Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese” miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Arsimit nr. 105, datë 23.02.2012;²
4. Aktet të tjera nënligjore që rregullojnë/normojnë botimet në institucionet publike të arsimit të lartë.

Neni 2

Botimet Mësimore – Shkencore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

1. Botimet kryesore mësimore-shkencore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli i Botimeve përfshijnë:
 - a. Tekstet mësimore për studentët;
 - b. Tekstet formues dhe shkencore për ciklin e tretë të studimeve dhe për edukimin në vazhdim të profesionistëve në fushat e mjekësisë;
 - c. Monografitë.
2. Përbëjnë objekt miratimi në Këshillin e Botimeve edhe përkthimet, ribotimet si dhe tekste të tilla si:
 - a. libër ushtrimesh,
 - b. praktikume laboratorike,
 - c. atllase,
 - d. albume,
 - e. Fjalorë të terminologjive mjekësore, etj.
3. Të gjitha botimet e miratuara duhet të përmbajnë elementë të mirëfilltë të ekselencës pedagogjike dhe kërkimit shkencor.
4. Autorë të teksteve që miratohen nga Këshilli i Botimeve janë anëtarë të stafit akademik të UMT me eksperiencë akademike dhe shkencore.
5. Mund të aplikojnë për vlerësim të monografive edhe personel akademik me kohë të pjesshme të UMT, të IAL-ve të tjera në vend apo punonjës kërkimorë-shkencorë në struktura të kërkimit shkencor me përvojë akademike dhe shkencore. Në këtë rast, aplikanti paguan një tarifë aplikimi të miratuar nga organet kolegjiale përgjegjëse.³
6. Autorët e teksteve që paraqiten për miratim, duhet të gëzojnë të paktën gradën shkencore “Doktor”

¹ Shtuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

² Shtuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

³ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

Neni 3⁴ Përkufizime

I. Përkufizimi i Tekstit Mësimor

- i. *Tekstet mësimore përfaqësojnë një botim akademik me natyrë shkencore dhe pedagogjike në lëndët mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe shkruhen plotësisht nga një autor, apo grup autorësh, të cilët ndajnë autorësinë e botimit për të gjithë tekstin, ose për kapituj të veçantë të tij. Tekstet mësimore përmbajnë kryesisht materiale pedagogjike që sjellin një kontribut të ri të rëndësishëm në procesin mësimor të shkencave mjekësore dhe shërbejnë si tekst bazë për lëndën përkatëse. Ata pajisen me numër ISBN dhe duhet të botohen nga një shtëpi botuese e njohur ligjërish, ku përfshihet edhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për botimet e financuara prej tij.*
- ii. *Teksti mësimor duhet të jetë i mbështetur në programin mësimor të lëndës përkatëse, të aprovuar nga dekanati përkatës.*
- iii. *Tekste të tillë duhet të kenë referenca shkencore bashkëkohore të paraqitura në bibliografinë shkencore në fund të çdo kapitulli.*
- iv. *Pranohen për shqyrtim edhe ribotimet, duke evidentuar përditësimet e kryera dhe duke përfshirë referenca kryesisht të 5 viteve të fundit.*

II. Përkufizimi i “Tekstit Shkencor” për studentët të ciklit të tretë të studimeve dhe për profesionistët

- i. *Tekstet shkencorë përfaqësojnë një punë madhore akademike me natyrë shkencore dhe profesionale në fushat dhe disiplinat e shkencave mjekësore dhe shkruhen plotësisht nga një autor, apo grup autorësh, të cilët ndajnë autorësinë e botimit për të gjithë tekstin. Tekstet shkencore përmbajnë kryesisht material të pabotuar më parë dhe sjellin një kontribut të ri të rëndësishëm në një fushë të caktuar të shkencave mjekësore, gjithashtu këto pajisen me numër ISBN. Tekstet shkencore duhet të botohen nga një shtëpi botuese e njohur ligjërish, ku përfshihet edhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për botimet e financuara prej tij.*
- ii. *Autori/autorët e tekstit shkencor të hartuar për studentët e ciklit të tretë dhe për profesionet mjekësore duhet të jenë autoritete shkencore në disiplinën që trajtohet. Këto tekste duhet të përmbajnë informacion shkencor të azhurnuar në fushën përkatëse, të bazuar kryesisht në “evidence-based medicine”. Tekste të tillë duhet të kenë referenca shkencore bashkëkohore të cituara në tekst dhe të referuara në bibliografinë shkencore në fund të çdo kapitulli.*

III. Përkufizimi i “Monografisë”

- i. *Monografia përkufizohet si një trajtim shkencor origjinal shterues në një fushë të veçantë të një discipline shkencore, hartuar nga një autor i vetëm, i cili ka përvojë dhe ka dhënë kontribut origjinal në fushën përkatëse të dokumentuar nëpërmjet artikujve shkencore.*

⁴ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

- ii. *Monografia përbën një punim shkencor origjinal të autorit në një fushë specifike, duke e shtjelluar atë në mënyrë të hollësishme dhe të plotë. Përpara kërkesës për botim të monografisë, autori duhet të provojë kontributin e tij origjinal në fushën përkatëse nëpërmjet artikujve shkencore të publikuar në fushën që trajton monografia, ndër të cilët, të paktën një artikull të jetë i botuar nga autori në një revistë ndërkombëtare të indeksuar në Scopus ose Web of Science në 5 vitet e fundit. Monografia duhet të ketë referenca shkencore të cituara në tekst dhe të referuara në bibliografinë shkencore në fund të tekstit. Të paktën 50% e referencave duhet t'i përkasin 10 viteve të fundit.*

Neni 4

Kriteret dhe standardet e vlerësimit të botimeve

- I. Kriteret dhe standardet e vlerësimit të teksteve mësimore, monografive dhe teksteve shkencore përfshijnë:
1. Baraspeshën e paraqitjes së përmbajtjes dhe mbulimit të tematikës së përshkruar;
 2. Origjinalitetin dhe forcën argumentuese të qëllimit të studimit, të shpalosur në një përjasje inovative, me elementë shkencore unikë, që çojnë përpara nivelin e përgjithshëm të dijeve në një fushë të caktuar;
 3. Strukturën logjike, koherencën tematike dhe organizimin efektiv të punimit;
 4. Respektimin e standardeve akademike të UMT-së;
 5. Prova të qarta të lexueshmërisë së mirë të materialit dhe të nevojave të target grupeve të përdoruesve të informacionit të paraqitur;
 6. Argumentimin e qartë sesi materiali i paraqitur do të përmirësojë nivelin e dijeve, krahasuar me botimet ekzistuese;
 7. Vlerat akademike të autorit, që përfshijnë listën e tij të botimeve, vlerësimet e marra, përkthimet apo publikimet e tjera të kaluara në proces;
 8. Referencat dhe recensat e specialistëve të njohur të fushës së studimit;
 9. Planin e fizibilitetit të botimit.

Neni 5

Recensentët e publikimeve shkencore

1. Këshilli i Botimeve shqyrton paraprakisht dorëshkrimet e paraqitura për miratim, për të vlerësuar nëse janë në përputhje me procedurat dhe kriteret e miratuara. Kur janë konform kriterëve, Këshilli ia përcjell oponentëve (recensentëve) sipas tipit të tekstit.
2. Recensentët duhet të jenë figura të spikatura akademike dhe profesionale të shkencave mjekësore me të paktën 15 vjet eksperiencë profesionale dhe akademike dhe titullin shkencor të paktën “Profesor i Asociuar”.

3. Recensentët dhe Këshilli i Botimeve mbikëqyrin cilësinë dhe nivelin profesional dhe shkencor të dorëshkrimeve të paraqitura. Recensentët duhet t'i përkasin fushave të përafërta të studimit dhe ekspertizës me fushën e tekstit të paraqitur për botim.⁵

Neni 6⁶

Procedurat dhe kërkesat për shqyrtimin e teksteve

1. Autorët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në UMT, paraqesin kërkesat për miratimin e dorëshkrimeve të tyre në njësinë bazë (departamentin) ku ata zhvillojnë aktivitetin akademik ose në një njësi bazë të përafërt në varësi të tematikës që mbulon teksti. Jo më vonë se, një muaj pas dorëzimit, departamenti e përcjell dorëshkrimin me komentet eventuale, nëpërmjet dekanatit përkatës në Rektoratin e UMT-së. Përcjellja bëhet në Zyrën e Protokollit të UMT-së dhe në shkresën përcjellëse cilësohet që kërkesa i drejtohet edhe Këshillit të Botimeve të UMT-së.
2. Autorët personel akademik me kohë të pjesshme në UMT i paraqesin Rektorit dhe Këshillit të Botimeve në UMT kërkesat për miratimin e dorëshkrimeve të tyre, kërkesa të cilat depozitohen në Zyrën e Protokollit të UMT-së. Këta autorë duhet të paraqesin edhe një letër mbështetëse për tekstin nga drejtuesi i njësisë bazë të UMT, ku kryejnë aktivitetin si personel me kohë të pjesshme.
3. Autorët personel akademik në IAL të tjera në vend apo punonjës kërkimorë-shkencorë në struktura të kërkimit shkencor i paraqesin Rektorit dhe Këshillit të Botimeve në UMT kërkesat për miratimin e dorëshkrimeve të tyre, kërkesa të cilat depozitohen në Zyrën e Protokollit të UMT-së. Këta autorë duhet të paraqesin edhe një letër mbështetëse për tekstin nga titullari i IAL/institucionit ku kryejnë aktivitetin shkencor.
4. Në rast të monografive të paraqitura sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, Këshilli i Botimeve përcakton njësinë bazë më të përshtatshme për vlerësimin e tyre dhe ia dërgon për vlerësim me shkresë përcjellëse nëpërmjet Rektorit të UMT.
5. Autori duhet ta dorëzojë dorëshkrimin në 3 (tri) kopje të printuara në format A4, të shkruara me karakter shkronje "Times New Roman" dhe madhësi shkronje 12, me hapësirë 2 (dy) në të gjitha nivelet e tekstit, së bashku me një kopje elektronike.
6. Organizimi i dorëshkrimit duhet të ndjekë skemën e mëposhtme:
 - a. Faqja e titullit, që përmban titullin e punimit, emrin e plotë të autorit/autorëve dhe përkatësinë profesionale dhe akademike të tyre;
 - b. Pasqyra e lëndës, që përmban titujt e kapitujve, të karakterit informues – përshkruues;
 - c. Kapitujt konsektivë të dorëshkrimit, ku çdo kapitull fillon në një faqe të re;
 - d. Apendikset ose Shtojcat (nëse ka të tilla);
 - e. Referencat.
7. Çdo dorëshkrim duhet të shoqërohet me një letër shoqëruese apo kërkesë ku autori/autorët konfirmojnë:
 - a. Origjinalitetin e punimit;

⁵ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

⁶ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

- b. *Raportin me konfliktin e interesit dhe burimet eventuale të financimit;*
- c. *Respektimin e Kodit të Etikës në kërkimin shkencor dhe të drejtës së privatësisë, konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale për studime që përfshijnë pacientë/individë.*
8. *Në rastin e teksteve mësimore, autori duhet të paraqesë edhe planin mësimor të lëndëve për të cilën është hartuar teksti. Ky plan mësimor duhet të jetë i konfirmuar nga njësis kryesore përkatëse.*
9. *Në rastin e kërkesës për botim të një monografie, autori:*
- i. *duhet të paraqesë edhe evidencën e publikimit të të paktën një artikulli sipas specifikimeve të nenit 3, pika III si dhe*
 - ii. *duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Fitimin e Titujve Akademike në UMT, konkretisht botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësis bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT.*
10. *Në çdo rast autori duhet të paraqesë edhe evidencën e gradës/titullit shkencor që mbart.*
11. *Dorëshkrimi duhet të jetë i korrigjuar nga ana letrare dhe i redaktuar nga ana shkencore.*
12. *Formularët e nevojshëm për procesin e aplikimit të dorëshkrimeve hartohen dhe miratohen nga Këshilli i Botimeve i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.*

Neni 7

Procedura e recensimit

1. *Këshilli i Botimeve në UMT shqyrton dhe eventualisht miraton, botimin e publikimeve në bazë të miratimit me shkrim të të paktën dy recensentëve (në rastin e teksteve për ciklin e tretë dhe profesionistë, numri i recensentëve është 3) të fushës përkatëse.*
2. *Recensentët caktohen në konfidencialitet nga Kryetari i Këshillit të Botimeve dhe identiteti i tyre mbahet i fshehtë deri në përfundimin e recensimit. Preferohet që recensentët të mos jenë anëtarë të shërbimit/njesisë ku bën pjesë edhe autori/autorët e teksteve.*
3. *Punën vlerësuese për një dorëshkrim, recensentët janë të detyruar ta përfundojnë brenda një periudhe së shumti 30 (tridhjetë) ditore nga dorëzimi zyrtar i materialit nga Këshilli i Botimeve.*

*Recensentët janë të detyruar të shkruajnë recensionin me përfundim pozitiv apo negativ në një raport të argumentuar, të ndarë nga njëri – tjetri.*⁷

4. Dorëshkrimi pranohet për vazhdimin e procedurës, kur të dy recensionet janë pozitivë (në rastin e teksteve shkencore për ciklin e tretë të studimeve dhe për profesionistët, të paktën dy nga 3 (tri) recensentët duhet të kenë shprehur opinion pozitiv); në të kundërtën i kthehet autorit për ripunimin e materialit, bazuar në vërejtjet e bëra. Nëse autorët nuk i plotësojnë vërejtjet e bëra nga recensentët brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli i Botimeve për ripunimin e materialit, pa arsye madhore të dokumentuara, konsiderohet se kanë hequr dorë nga vazhdimi i procedurës së mëtejshme të botimit.
5. Në rastet e mospajtimit dhe konfliktit midis autorit dhe recensentëve, vendimin përfundimtar e merr Këshilli i Botimeve.
6. Përparësi botimi dhe financimi në UMT kanë tekstet mësimorë të lëndëve që zhvillohen në UMT.
7. Botimet e tjera të tilla si përmbledhje ushtrimesh, praktika laboratorike, fjalore, albume etj. Ndjekin procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Këshillin e Botimeve sipas përkatësisë së tyre në qëllimin e tekstit dedikuar studentëve apo dedikuar profesionistëve të mjekësisë apo studentëve të ciklit të tretë.

Neni 8⁸

Formati zyrtar i publikimeve në UMT

Publikimet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përmbajnë në kopertinë: emrin e Universitetit; emrin e Fakultetit përkatës; emrin dhe mbiemrin bashkë me titullin akademik të autorit/autorëve; titullin e tekstit; logon e Universitetit; vendin dhe vitin e botimit. Faqja e parë e tekstit është e njëjtë me kopertinën, por e shtypur në bardhë e zi (pa ngjyra); në faqen e dytë shënohen emrat dhe titujt e recensentëve, redaktorit, të botuesit, ISBN dhe në fund të faqes numri i vendimit të Këshillit Botues me këtë përmbajtje: “Këshilli i Botimeve i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë vendosi botimin e kësaj/këtij monografie/teksti me vendimin Nr. _____, datë ____; ____, _____.” Më tej vijojnë pasqyra e lëndës, që përmban titujt e kapitujve; parathënia; kapitujt konsektivë; apendikset ose shtojcat dhe referencat. Në faqen e fundit shënohen emri, mbiemri dhe titulli i autorit/autorëve, emri, mbiemri dhe titulli i recensentëve, redaktorit shkencor, redaktorit letrar, realizuesit kompjuterik dhe autorit të ilustrimeve grafikë dhe artistikë. Në publikim shënohen mbajtësit e të drejtës së autorit dhe shprehja “Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen më ligj”. Në të gjitha faqet e tekstit duhet të figurojë si header emri i autorit dhe titulli i publikimit. Në faqen e fundit të tekstit botohet katalogimi bibliografik i Bibliotekës Kombëtare (CIP) dhe ISBN.

⁷ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

⁸ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

Neni 9⁹

Përkthimet në UMT

1. *Këshilli i Botimeve pranon për shqyrtim përkthime të paraqitura nga personeli akademik me kohë të plotë i UMT-së dhe të mbështetura nga njësitë bazë përkatëse.*
2. *Përkthyesit/redaktorët shkencorë duhet të paraqesin pranë Këshillit të Botimeve:*
 - i. *Kërkesën për miratim të përkthimit, të dorëzuar në zyrën e protokollit të UMT-së dhe ku cilësohet që kërkesa i drejtohet edhe Këshillit të Botimeve të UMT-së;*
 - ii. *Miratimin e njësisë bazë përkatëse;*
 - iii. *Dokumentin që vërteton marrëveshjen e copyright/autorizimin e të drejtës së përkthimit në gjuhën shqipe.*
3. *Këshilli i Botimeve bën vlerësimin e tekstit, përshtatshmërinë me kurrikulën, cilësinë e përkthimit/redaktimit dhe merr vendimin përkatës.*

Neni 10

Detyrimet e autorëve

1. *Çdo publikim jashtë kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, konsiderohet botim pa leje dhe nuk ka vlerë akademike universitare.*
2. *Pas botimit, jo më vonë se 3 muaj nga marrja e vendimit paraprak të miratimit të tekstit, autori është i detyruar të dorëzojë pranë Rektoratit të UMT, njësisë kryesore dhe Këshillit të Botimeve të UMT nga 1 (një) kopje të tekstit, pranë Bibliotekave Shkencore të UMT dhe të njësisë kryesore nga 2 (dy) kopje dhe pranë Bibliotekës Kombëtare 3 (tre) kopje të tij.¹⁰*

Neni 11

Aprovimi dhe modifikimi i rregullores

1. *Kjo Rregullore miratohet paraprakisht nga Këshilli i Botimeve me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.¹¹*
2. *Ajo mund të ndryshohet me kërkesë të Kryetarit, Zv. Kryetarit ose me kërkesën e 2/3 te anëtarëve të pranishëm të Këshillit të Botimeve.¹²*
3. *Miratimi përfundimtar i kësaj Rregulloreje bëhet nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.*

⁹ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

¹⁰ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

¹¹ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

¹² Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 101, datë 03.10.2025.

Neni 12
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e mëparshme mbi Botimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, shfuqizohet.

Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, më datë 29.04.2022.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Emri, Mbiemri
Nënshkrimi dhe vula e institucionit